




# Gripi i derrave

## Këshilla për të sëmurët

- Pini më shumë lëngje,
- Pushoni,
- Merrni ushqim cilësor me vitamina.

Ekziston terapia antivirale, e cila duhet të përdoret pas përshkrimit nga ana e mjekut. Terapia në fjalë është e suksesshme nëse merret sa më shpejt pas paraqitjes së shenjave të sëmundjes.



Përpiluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë  
Publike të Kosovës  
përkrahur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë  
zyra në Prishtinë, përmes fondeve të Qeverisë së  
Luksemburgut

Nëse ju përkeqësohet gjendja  
shëndetësore lajmërohuni  
tek mjeku Juaj !



i

Atë çka  
duhet të  
dini

## Çka është gripi i derrave?

Është sëmundje e organeve të frymëmarrjes të derrave e shkaktuar nga virusi i gripit i tipit A.

Njerëzit zakonisht nuk sëmuren nga gripi i derrave, por infeksioni ndër njerëz mund të ndodh. Aktualisht tek njerëzit është raportuar infeksioni me virusin e gripit të derrave tipi H1N1.



## Cilat janë shenjat e sëmundjes së gripit të derrave ndër njerëz?

Shenjat janë të njëjta me ato të gripit të zakonshëm:

- temperaturë, kollë, dhembje fyti,
- dhembje koke,
- dhembje trupi,
- plogështi.
- Vjellja dhe barkqitja në disa raste.

Komplikim më i shpeshtë i sëmundjes është kallja e mushkërive.

## Si përhapet gripi i derrave ndër njerëz?

Virusi i gripit të derrave përhapet në të njëjtën mënyrë si gripi i zakonshëm (sezonal). Virus i përhapet përmes ajrit nga një person në tjetrin gjatë kollitjes dhe teshtitjes së personave të sëmurë me grip.

Virusi përhapet edhe duke prekur gojen, hundën dhe sytë me duart e papastërta apo gjësendet që përmbajnë virusin e gripit.

Personi i infektuar me virusin e gripit të derrave përhapë sëmundjen tek personat tjerë 1 ditë para se të shfaqen shenjat e sëmundjes dhe 7 ditë pasi të jenë shfaq shenjat e sëmundjes.



## Si parandalohet sëmundja?

Nuk ka vaksinë e cila mbron kundër gripit të derrave, por sëmundja mund të parandalohet nëse respektohen këto parime:

- ▶ Mbuloje hundën dhe gojën me faculetë gjatë kollës dhe teshtitjes.
- ▶ Hudhe në vend të sigurtë faculetën pas përdorimit,
- ▶ Pastroji rregullisht duart me sapun dhe ujë të nxehtë veçënërisht pas kollës, teshtitjes dhe prekjës të gjësendeve,
- ▶ Mos prek sytë, hundën dhe gojën me duart të papastërta
- ▶ Evitoni kontaktet me personat e sëmurë nga gripi
- ▶ Nëse sëmuresh nga gripi mos shko në punë, shkollë, hapësira publike. Qëndro në shtëpi për të parandaluar përhapjen e infeksionit.

